



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë - Ministarstva za Obrazovanje Nauku i Tehnologiju - Ministry of Education, Science and Technology

Kabineti i Ministrit/Kabinet Ministra/Cabinet of the Minister

Prishtinë, më 13 nëntor 2017

Ref. nr: 237/018

Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në mbështetje të dispozitave të neneve 4, 21, 22 të Ligjit Nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare, Nr. 82, 21 tetor 2010), deponitave të nenit 8 dhe shtojcën 6 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (Gazeta Zyrtare, Nr. 1, 18 prill 2011), duke u bazuar në nenin 6, paragrafi 1.11, të Ligjit nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Gazeta Zyrtare nr. 14, 9 shtator 2011) dhe nenin 10, paragrafi 1, të Udhëzimit Administrativ nr. 25/ 2012 Licencimi i Bartësve Privat të Arsimit të Lartë në Kosovë (dt. 22 tetor 2012), nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Emërohet Komisioni i veçantë për shqyrtimin e kërkesave për licencim të BPrAL në këtë përbërje:
 - 1.1. Drita Kadriu, Departamenti i Arsimit të Lartë;
 - 1.2. Shyhrete Reqica, Inspektorati i Arsimit në MASHT;
 - 1.3. Fadile Dyla, Departamenti i Infrastrukturës;
 - 1.4. Bekim Samadraxha, Departamenti i Arsimit të Lartë, (u.d. i Drejtorit të AKA-së);
 - 1.5. Bashkim Shala, Zyra Ligjore.
2. Komisioni i emëruar në pikën 1 të këtij vendimi, ka mandat 1 (një) vjeçar.
3. Komisioni i emëruar në pikën 1 të këtij vendimi, obligohet të shqyrtoj kërkesat për licencim sipas kushteve dhe kriterëve ligjore për licencim të përcaktuara në nenin 14 të Ligjit nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës dhe nenit 7 të Udhëzimit Administrativ nr. 25/ 2012 Licencimi i Bartësve Privat të Arsimit të Lartë në Kosovë.
4. Në përputhje me nenin 8 të Udhëzimit Administrativ nr. 25/2012 për Licencimin e Bartësve të Arsimit të Lartë në Kosovë, kërkesat që përmbajnë dokumentacion të pakompletuar nuk do të shqyrtohen dhe Komisioni do të njoftoj me shkrim BPrAL për refuzimin e kërkesës për licencim dhe mbi arsyet e refuzimit.

5. Komisioni i emëruar në pikën 1 të këtij vendimi, do të nxjerr vendim për licencim të BPrAL që ka plotësuar kushtet dhe kriteret e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
6. Në përputhje me nenin 14 të Udhëzimit Administrativ nr. 25/2012, Komisioni i emëruar në pikën 1 të këtij vendimi, do të nxjerr vendim për mosdhënien e licencës të BPrAL që nuk i plotëson kushtet dhe kriteret e përcaktuara me legjislacionin në fuqi, në rast që ka ofruar të dhëna të pasakta dhe në rast që BPrAL ka filluar punën në kundërshtim me ligjin pa u pajisur paraprakisht me licencë nga MASHT.
7. Komisioni i emëruar në pikën 1 të këtij vendimi, obligohet brenda periudhës së përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi të dorëzoj raportin zyrtar për secilin subjekt aplikues (jo më vonë se 7 (shtatë) ditë nga shqyrtimi dhe vendosja për kërkesën për licencimin) në të cilën konstaton gjendjen faktike dhe vendimin për mosdhënien e licencës.
8. Në rast të parregullsive apo lëshimeve të Komisionit të emëruar në pikën 1 të këtij vendimi, përkatë procesit të shqyrtimit të kërkesave të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi, do të merren masat disiplinore sipas neneve 64,65,66,67 të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.
9. Komisioni i emëruar në pikën 1 të këtij vendimi, kompensohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.
10. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i MASHT dhe Drejtori i Departamentit të Arsimit të Lartë në MASHT, në zbatimin e këtij vendimi.
11. Vendimi hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit.



Shyqiri Bytyqi, Ministër

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

Vendimi ju dërgohet:

- Anëtarëve të Komisionit;
- Sekretarit të Përgjithshëm të MASHT;
- Departamentit të Arsimit të Lartë, MASHT;
- Arkivit të MASHT.